Kronikë

Lumi i Shalës fut në sherr konkurrence 2 familje në Vaun e Dejës, nën akuzë babë dhe bir! Kanosën me armë pneumatike 58-vjeçarin, shkak biznesi i varkave shëtitëse

Incidenti prej ditësh u mbyll me kanosje, Policia i procedon, bllokon armën dhe një thikë. Tre akuza ndaj të dyshuarve, mosmarrëveshje për aktivitetin fitimprurës të shëtitjes së turistëve në luginë me varka

Varka ne lumin e Shalës

Redaksia
26 Gusht, 11:45 | **Përditesimi: 26 Gusht, 11:50**

Share

Shkodër- Zonat e lakmuara turistike nuk janë vetëm atraktive për vizitorët vendas dhe të huaj, por edhe burim biznesi për subjekte dhe individë që operojnë në ato zona, shpesh duke sjelle edhe ngjarje të pakëndshme.

Një rast i tillë ka ndodhur në zonën e Vaut të Dejës, mes dy familjeve në konflikt konkurrence për biznesin e transportit me varka të turistëve, në luginën e Lumit të Shalës.

Mosmarrëveshjet kanë denigruar ditët e fundit deri në kërcënimin me jetë me një armë pneumatike nga dy të dyshuar babë dhe bir, ndaj 'rivalit' të tyre 58-vjeçar.



LEXO EDHE:
VIDEO/ Lumi i Shalës, 'parajsa e vogël' që po çmend dhe të huajt! Deri para pak vitesh sekret, sot destinacion i preferuar

Policia e Shkodrës konfirmoi sot (26 Gusht) ngjarjen, duke proceduar penalisht K.N., 55 vjeç dhe R.N., 24 vjeç, banues në Vaun e Dejës.

Gjatë kontrolleve në banesë atyre, u gjetën arma pneumatike dhe 1 mjet prerës thikë, që mbaheshin pa leje.

Denoncimi ishte depozituar nga vetë 58-vjeçari i kanosur. Pas shoqërimit dhe marrjes në pyetje, babë dhe bir u lanë për hetime në gjendje të lirë, teksa kanë pretenduar agresion dhe kërcënime nga paditësi.

Ndaj tyre janë ngritur 3 akuza për veprat penale "kanosja", "prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të flohta" dhe "prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të gjuetisë dhe sportive". Dosja për rastin i ka kaluar prokurorisë vendore.

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: lumi i shales | vau i dejes | Shkoder

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Diplomacia, a ka ndryshuar imazhi i Shqipërisë në arenën ndërkombëtare?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Shkodër, Tifozat e Tiranës hedhin kapsolla në fushë pas golit të Vllaznisë e përplasën me policinë! 4 në pranga 1 në kërkim
26 Gusht, 07:35

Muriqan/ Po udhëtonte drejt Malit të Zi me hashash në makinë, nën akuzë 25-vjeçarja kosovare
25 Gusht, 12:42

Fushë Arrëz/ Po bënte punime në rrjetin elektrik, rrëzohet shtylla dhe bie 54- vjeçari
24 Gusht, 16:04

Atentat i dështuar në Bushat të Vaut të Dejës! Qëllohet me breshëri kallashnikovi ndaj 'Audit' të blinduar, në kërkim vëllezërit Prendi e një tjetër
Ergys Kavaja
24 Gusht, 11:29

Shkodër/ Asgjësohen 361 bimë kanabis, vihet në pranga 67-vjeçari! Ja momenti kur kapet në flagrancë (VIDEO)
24 Gusht, 10:31

Bushat/ Qëllohet me armë drejt një 'Audi', dyshohet se ka pasur shkëmbim zjarri nga dy makina! Gjenden 10 gëzhoja! S'ka të lënduar
23 Gusht, 20:08

FOTOT/ Ja si do të duket zona e Zdrales në Shkodër pas transformimit! Tenderi 275 milionë lekë, pritet nisja e punimeve
23 Gusht, 12:52

Operacioni antikanabis vijon në Malësi të Madhe e Shkodër, në total asgjësohen 1800 fidanë
23 Gusht, 10:37

Vrasja e dyfishtë në Velipojë, Gjykata lë në qeli dy punëtorët e arrestuar, në arrati 2 vëllezërit pronarë të hotel 'Holiday'! Kamerieri: E pashë kush qëlloi
22 Gusht, 14:36

Shoku vdiq në Velipojë, italiani: U përplasëm me Jet-Ski, por ai ra në det nga dallga! 50 ditë burg për 20-vjeçarin
Ergys Kavaja
22 Gusht, 13:36

Shkodër/ Çelet tek 'Marubi' ekspozita e rrallë 'Vëllezërit Kodheli dhe Kolë Idromeno, Rilindja në Artin Pamor Shqiptar'
Ergys Kavaja
21 Gusht, 16:52

Malësia e Madhe 'luftë' si Lazarati, trafikantët e drogës qëllojnë në ajër sa shohin efektivët dhe arratisen! RENEA dhe FNSH rrethojnë zonën (VIDEO)
21 Gusht, 12:33

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje